

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6826  
E mërkurë, 15 shkurt 2023  
çmimi 0.40 €

Osmani: Kosova dhe Shqipëria janë të përcaktuara për rrugën evropiane | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MINISTRI I SHËNDETËSISË, ARBEN VITIA, KA RAPORTUAR PARA ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI NË KUVENDIN E KOSOVËS

## OPOZITA: SHËNDETËSIA NUK ËSHTË PRIORITET I QEVERISË KURTI



Ministri i Shëndetësisë, Arbën Vitia, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës, ku ka shpalosur prioritetet e tij për këtë vit. Ndërkaq deputetët e opozitës

drejtuan një varg kritikash për ministrin Vitia dhe qeverinë Kurti. Sipas tyre, shëndetësia nuk është prioritet i kësaj qeverie. "Shëndetësia kurrë më keq nuk ka qenë. Ka mungesë të barnave esenciale, kemi lista të pritjes,

trajtime jashtë vendit me borxhe milionëshe dhe ikje të profesionistëve shëndetësorë. Gjithashtu, ka regres në përcaktim të menaxherëve të shëndetësisë", ka thënë deputeti Shemsedin Dreshaj

## DEPUTETËT E SHQIPËRISË JAPIN MBËSHTETJE PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BE DHE KE | **FAQE 3**



## AKSIONI I PSD-SË PARA QEVERISË: PËR DY VJET QEVERISJE NUK IA KANË BA VIJË | **FAQE 7**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

## SPORT

**DITA 1 FINAL 8**  
KUPA E KOSOVËS  
BORA vs ISTOGU 14:00  
TREPÇA vs VËLLAZNIMI 17:00  
RAHOVECI vs PEJA 20:00

SOT FILLON FESTIVALI I BASKETBOLLIT NË RAHOVEC | **F. 10**

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Shpresat e fundit për të nxjerrë të mbijetuar nga tërmetet

ANKARA, 14 SHKURT - Ekipet e kërkim-shpëtimit kanë vazhduar punën e tyre edhe të martën për të nxjerrë njerëz nën rrënoja në tri provinca të prekura rëndë nga tërmetet shkatërruese që goditën Turqinë dhe Sirinë javën e kaluar. Numri i të vdekurve nga tërmetet me magnitudë 7.8 dhe 7.5 që tronditën Turqinë juglindore dhe Sirinë veriore më 6 shkurt kaloi shifrën prej 35 000 njerëzish, teksa ekspertët paralajmërojnë se ky numër do të rritet.

Ekspertët thanë se dritarja për të gjetur të mbijetuar po mbyllet. Tre persona u shpëtuan nga një ndërtesë që është shkatërruar në qendër të Kahramanmaras, pranë epiqendrës, të martën, rreth 198 orë pas tërmetit.

Gjendja shëndetësore e të mbijetuarve nuk dihet ende.

Në Siri, presidenti Bashar Assad, ra dakord të hapë dy pika të reja kalimi nga Turqia në veriperëndim të vendit të kontrolluar nga rebelët për ta ofruar ndihmën dhe pajisjet e nevojshme për miliona viktime të tërmetit, njoftuan Kombet e Bashkuara të hënën.

Vendkalimet në Bab Al-Salam dhe Al Rae do të hapen për një periudhë fillestare prej tre

muajsh.

Deri më tani OKB-së i është lejuar të dërgojë ndihma në zonën e Idlibit vetëm përmes një kalimi të vetëm në Bab Al-Haua.

Kombet e Bashkuara kanë qenë nën presion të madh që të dërgojnë më shumë ndihma dhe pajisje të rënda në veriperëndimin e Sirisë të kontrolluar nga rebelët, me të mbijetuar që u mungojnë mjetet bazike për të gërmuar për të mbijetuar të tjerë, teksa numri i të vdekurve është në rritje.

Avioni i parë me ndihma nga Arabia Saudite, me 35 tonë ushqime, u ul në aeroportin e Alepos të mbajtur nga qeveria të martën në mëngjes, sipas medieve shtetërore siriane.

Arabia Saudite ka mbledhur rreth 50 milionë dollarë në një fushatë publike për ta ndihmuar Turqinë dhe Sirinë. Disa vende të tjera arabe kanë dërguar avionë të ngarkuar me ndihma në Sirinë e kontrolluar nga qeveria, duke përfshirë Jordaninë dhe Egjiptin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Algjerinë, Irakun, Omanin, Tunizinë, Sudanin dhe Libinë. Të gjitha këto vende i kanë dorëzuar ndihmat në Damask.

Tërmeti preku 10 provinca në



Turqi, ku jetojnë rreth 13.5 milionë njerëz, si dhe një zonë të madhe në Sirinë veriperëndimore, që është shtëpi e miliona njerëzve.

Më shumë se 41 mijë e 500 ndërtesa u shkatërruan ose u dëmtuan shumë, tha ministri i Mjedisit dhe Urbanizimit të Turqisë. Nën ato ndërtesa ka trupa dhe numri i të zhdukurve mbetet i paqartë.

Shumë në Turqi fajësojnë ndërtimin e gabuar për

shkatërrimin e madh. Turqia ka rregulla ndërtimi që plotësojnë standardet e inxhinierisë së tërmeteve, por ekspertët thonë se këto rregulla zbatohen rrallë.

Numri i të vdekurve në Turqi ishte 31,643 të hënën. Zyrtarët kanë ulur frekuencën e përditësimeve të numrit të vdekjeve dhe tani lëshojnë përditësime më të mëdha një ose dy herë në ditë.

Numri i të vdekurve në rajonin veriperëndimor të kontrolluar

nga rebelët ka arritur në 2 166, sipas grupit të shpëtimit Helmetat e Bardha, ndërsa 1,414 njerëz kanë vdekur në zonat e kontrolluara nga qeveria, sipas Ministrisë siriane të Shëndetësisë në Damask. Numri i përgjithshëm i të vdekurve në Siri është 3 580.

Kabineti i presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan ka planifikuar një takim të martën, ku do të adresohet tërmeti shkatërrues.

## Baerbock mbështet kërkesën e Finlandës dhe Suedisë për anëtarësim në NATO



BERLIN, 14 SHKURT - Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, ka filluar një vizitë dyditore në Finlandë dhe Suedi, gjatë së cilës ajo tha se do ta shprehë angazhimin e saj për të mbështetur kërkesat e të dy vendeve nordike për t'u bërë anëtare të NATO-s.

Baerbock vuri në dukje se sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës shënoi një pikë kthese të rëndësishme për të dy kombet. Ajo theksoi se pas vitesh mospjesëmarrjeje në aleancat ushtarake, Finlanda dhe Suedia kanë vendosur të anëtarësohen në NATO. "Pas 80 vjetësh të politikës së Finlandës, dhe 200 vjetëve të politikës së

Suedisë për mospjesëmarrje në aleancat ushtarake, të dy vendet kanë vendosur të anëtarësohen në NATO", tha Baerbock.

Dy vendet nordike, Finlanda dhe Suedia, kërkuar anëtarësimin në NATO menjëherë pas pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit të kaluar, dhe derisa shumica e vendeve anëtare kanë ratifikuar aplikimet e dy vendeve, Turqia kundërshton kandidaturën e Suedisë.

Turqia si vend anëtar i aleancës me të drejtë vetoje, i ka shtyrë për kohë të pacaktuar bisedimet e anëtarësimit për këto dy shtete. Ankaraja ka refuzuar që t'i

ratifikojë aplikimet e këtyre dy shteteve për në NATO, pikë së pari për shkak të refuzimit të Suedisë që të ekstradojë dhjetëra të dyshuar, që Turqia pretendon se janë të lidhur me luftëtarët kurdë dhe me puçin e dështuar të vitit 2016.

Suedia ka diasporë më të madhe kurde sesa Finlanda dhe ka më shumë mospajtime me Ankaranë.

Suedia është aleatja më e afërt mbrojtëse e Finlandës. Në rast të një konflikti me Rusinë, me të cilën Finlanda ndan një kufi prej 1.300 km, NATO-s do t'i duhej territori suedez për ta ndihmuar Finlandën të mbrohej.

## "Credit Suisse" ngrin mbi 19 miliardë dollarë fonde të lidhura me Rusinë

BERN, 14 SHKURT - "Credit Suisse", një kompani e madhe e shërbimeve financiare zvicerane, ka bërë me dije se ka ndërmarrë veprime për të ngrirë mbi 19 miliardë dollarë para ruse në përgjigje të zbatimit të sanksioneve perëndimore.

Masa është pjesë e një përpjekjeje më të gjera të

vendeve perëndimore për të bërë presion ndaj Rusisë për pushtimin e saj në Ukrainë dhe për ta kufizuar qasjen e saj në tregjet financiare globale.

Sipas gazetës "Sonntags Zeitung", disa nga fondet e ngrira i përkasin Bankës Qendrore Ruse ose shtetit rus. Për shumë vjet Zvicra ka qenë një destinacion i famshëm për

elitat ruse dhe vende të tjera ish-sovjetike që kërkojnë të çojnë pasurinë e tyre në një vend me rregulla më të dobëta bankare.

Megjithatë, sanksionet e fundit e kanë bërë gjithnjë e më të vështirë që rusët të kenë qasje në sistemin financiar global, me shumë banka perëndimore që tani po mbyllin dyert e tyre për ta.



## Ish-kryetari i LV-së: Kurti po mashtron me vetëdije

PRISHTINË, 14 SHKURT - Ish-kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, tani në cilësinë e analistit politik, ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, po mashtron me vetëdije. I ftuar në "RTV Dukagjini", Ymeri ka thënë se plani franko-gjerman është produkt i negociimit të Kurtit. "Kurti i ka ndryshuar qëndrimet, por ajo që dëgjuam sot dhe mbrëmë çka ka thënë në 'Euronews' dhe krahasuar me javën e kaluar në seancë, ky nuk është ndryshim i qëndrimeve. Para 4 apo 5 ditëve ka thënë se do të negociohet. Sot na tha pa u taku me Lajçakun, kur kanë ardhur e kanë sjellë planin, duke thënë se nuk ndryshohet. Deri mbrëmë na thoshte ky është i negociueshëm. Na ka mashtruar. Kurti po i ndryshon qëndrimet, por problemi është se po mashtron me vetëdije. Nëse e shohim javën e kaluar në Kuvend dhe sot, e kam vërejtur një gjë interesante. Sa herë që Kurti ndihet në siklet për shkak të argumenteve që nuk mund t'i ballafaqojë, i bënë dy gjëra: në

njërin anë i vendos disa mashtrime të tilla sa ta kalojë debatin, në anën tjetër egërsohet në sulmin ndaj opozitës", ka deklaruar Ymeri.

Ymeri ka theksuar se herën e fundit Kurti po e ka luftën me LDK-në. "Kurti është në siklet. Kritika e vetme ka qenë që Abdixhiku e ka pyetur a është njohja në qendër në planin franko-gjerman. Nëse jo, si erdhëm deri këtu? Sot Kurti e pranoi një gjë interesante, që plani franko-gjerman është një rrjedhojë e një negociimi që e ka bërë Kurti. Nuk është plani franko-gjerman që e kanë sjellë menjëherë pa folur me palët dhe kanë thënë se duhet ta pranoni gjithqysh", ka pohuar ai.

Ymeri ka thënë se plani franko-gjerman është produkt i negociimit të Kurtit teksa ka pyetur se "a është ky neglizhim i procesit, tejzgjatje e procesit, ajo që neve na ka futur në proces në kohën kur njëkohësisht është invazioni i Rusisë në Ukrainë".

Sipas Ymerit, Kurti e ka bërë pranimin, "por tash po do që ta



shpjegojë pranimin në formën më të dobët të politikanit ku nuk pranon kurrfarë përgjegjësie".

"Kurti po do të thotë që kurrfarë përgjegjësie nuk kam. Planin franko-gjerman na erdhi si merre

ose leje. Ai ka thënë që po e përmirësoj procesin e dialogut", ka pohuar Ymeri.

## Deputetët e Shqipërisë japin mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në BE dhe KE



Prishtinë, 14 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur një delegacion të Komisionit për Integrim Evropian të Kuvendit të Shqipërisë, i kryesuar nga

kryetarja e këtij komisioni, Jorida Tabaku, e i përbërë nga deputetë të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Partisë së Lirisë. Delegacioni ishte i shoqëruar nga ambasadori i Shqipërisë në

Kosovë, Qemal Minxhozi. Në takim u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e integritimit evropian dhe politikës së jashtme dhe për

nevojën e përhershme për bashkëpunim. Delegacioni dha mbështetjen e plotë për aplikimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, të dorëzuar në dhjetor të vitit të kaluar, dhe në Këshillin e

Evropës, të dorëzuar në maj të vitit 2022.

U bisedua edhe për marrëdhëniet e ngushta të dy vendeve dhe komunikimin e afërt ndërinstitucional, si dhe për zbatueshmërinë e marrëveshjeve bilaterale, me theks ato në fushën e ekonomisë dhe shkëmbimit tregtar.

Tabaku në emër të delegacionit e uroi kryeministrin Kurti për përvjetorin e 15 të pavarësisë së Kosovës. Kryeministri Kurti i falënderoi deputetët për vizitën, bashkëpunimin e deritanishëm dhe për gatishmërinë për të bërë edhe më shumë në shërbim të thellimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Delegacioni në fjalë, i përbërë nga Jorida Tabaku, Flutura Açka, Kreshnik Çolaku, deputetë të Partisë Demokratike, Etilda Gjonaj, Gerta Duraku, Lavdrim Krrashi, deputetë të Partisë Socialiste dhe Erisa Xhixho, deputete nga Partia e Lirisë, po qëndron në Kosovë dhe po zhvillon takime me përfaqësues institucionale dhe liderë politikë.

## Rama pret në takim Jim Xhemën, me emrin e tij do të emërtohet 'Rruga A' në Prishtinë

PRISHTINË, 14 SHKURT - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në vizitë veprimtarin shqiptaro-amerikan Jim Xhema. Me këtë rast, kryetari Rama i dha

mirënjohje veprimtarit Xhema për atdhedashurinë dhe punën e palodhshme për çlirimin e Kosovës. Rama ka thënë se ndihet falënderues ndaj veprimtarit Xhema për kontributin e tij

që ka dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ai ka bërë me dije se për ta nderuar veprën e tij, komuna e Prishtinës ka vendosur ta emërojë 'Rrugën A' me emrin e tij.





MINISTRI I SHËNDETËSISË, ARBEN VITIA, KA RAPORTUAR PARA ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI NË KUVENDIN E KOSOVËS

## Opozita: Shëndetësia nuk është prioritet i qeverisë Kurti

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës, ku ka shpalosur prioritetet e tij për këtë vit. Ndërkaq deputetët e opozitës drejtuan një varg kritikash për ministrin Vitia dhe qeverinë Kurti. Sipas tyre, shëndetësia nuk është prioritet i kësaj qeverie. “Shëndetësia kurrë më keq nuk ka qenë. Ka mungesë të barnave esenciale, kemi lista të pritjes, trajtime jashtë vendit me borxhe milionëshe dhe ikje të profesionistëve shëndetësorë. Gjithashtu, ka regres në përcaktim të menaxherëve të shëndetësisë”, ka thënë deputeti Shemsedin Dreshaj

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi në Kuvendin e Kosovës. Gjatë raportimit Vitia ka thënë se para vetes ka një sërë urgjencash dhe prioritete, derisa ka shtuar se ka mungesë të planifikimit. “Gjatë këtij viti do të miratohet Ligji për Shëndetësi, së bashku me atë për sigurime shëndetësore dhe këto dy ligje do të jenë thelbi i reformës në sektorin e shëndetësisë. Reformimi dhe përfundimi i inspektoratit shëndetësor, reformimi i ShSKUK-së, përfundimi i Agjencisë për Barna,

përfshirë Ligjin për Rregullimin e Barnave. Këto masa presim ta japin rezultatin e tyre këtë vit në gjashtëmuorin e parë. Ka një kulturë pune të munguar në planifikim”, ka thënë Vitia. Sipas tij, prioritetet janë edhe sigurimi i profesionistëve shëndetësorë në fushat deficitare, zvogëlimi i listave të pritjes, kontrolli i sigurisë së barnave dhe mbikëqyrja e institucioneve private për shërbimet që ofrojnë.

Vitia, po ashtu, ka bërë me dije se këtë vit planifikohet hapja e konkursit të ri për specializantët. Teksa ka folur për specializantët, Vitia ka thënë se me konkursin e ri do të ndajnë specializime me prioritet në lëmenjtë ku ka më shumë nevoja. Ai thënë se

prioritet i tij gjatë këtij mandati do të jetë edhe funksionalizimi i objektit të Emergjencës në QKUK, me ç’rast ka treguar se janë buxhetuar mjetet shtesë. Krahas funksionalizimit të këtij objekti, Vitia prioritetet ka përmendur edhe sigurimin e barnave esenciale dhe uljen e listës së pritjes.

Ndërkaq deputetët e opozitës e kanë kritikuar ministrin Vitia për gjendjen në shëndetësi.

Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, pati pyetje të shumta për ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia. Ai Vitinë e quajti përfaqësues të sektorit shëndetësor privat. “A do t’i braktisësh sërish pacientët dhe shëndetësinë? Ju thatë se antikorrupsioni po merret me ju. A keni pasur marrëdhënie kontraktuale me ‘Olive’? Sa ka qenë paga juaj? Çfarë pozite keni pasur? A keni punuar vetë apo edhe me ndonjë familjar? Pyetje nuk do të bëj për sektorin publik sepse asnjë premtim nuk e keni realizuar dhe ju jeni përfaqësues i sektorit privat. Skandalet janë të njëpasnjëshme. Ushtruesja e detyrës është ish-drejtoresha e Mytahir Haskukës. Ndoshta nuk është politike, por ta marrësh një drejtore të politike duke pasur mijëra menaxherë këtu, prapë

është çështje e juaja. Ministria e Shëndetësisë është shndërruar në drejtori të sektorit privat”, ka thënë Haxhiu.

Ndërsa Shemsedin Dreshaj nga AAK-ja e nisi debatin me Vitinë duke iu drejtuar se “ke ardhur taze”, madje ai konsideroi se sektori i shëndetësisë nuk është prioritet i kësaj qeverie. “Shëndetësia kurrë më keq nuk ka qenë. Ka mungesë të barnave esenciale, kemi lista të pritjes, trajtime jashtë vendit me borxhe milionëshe dhe ikje të profesionistëve shëndetësorë. Gjithashtu, ka regres në përcaktim të menaxherëve të shëndetësisë”, ka thënë ai.

E epititi që i dha Dreshaj Vitisë se është taze, këtij të fundit nuk i pëlqeu. “Nuk jam taze. Përgjegjësitë që më takojnë do ta kenë një emër. Të gjitha përgjegjësitë do të më adresohen mua, e se sa jam taze nuk do të çojë peshë”, ka thënë Vitia. Por lidhur me pyetjen e Dreshajt se kur Ligji për Shëndetësi dhe ai për Sigurime Shëndetësore do të vijnë në Kuvend, Vitia, pa dhënë ndonjë datë të caktuar, u shpreh se për këto ligje bazike kanë plan të hollësishtëm se kur do të sillen në Qeveri dhe Kuvend.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend

Zemaj, u shpreh se këto dy vjet do të dëshironin t’i harronin, por është e pamundur për shkak të, siç tha, problemeve të shumta në shëndetësi. Ish-ministri i Shëndetësisë para Komisionit Parlamentar për Shëndetësi u shpreh se gjatë këtyre dy vjetëve evidente ka qenë mungesa e barnave e listës esenciale, lista e pritjes e ikja e profesionistëve shëndetësorë. “Asnjë ligj bazik nuk ka ardhur për dy vjet dhe se jemi duke hyrë në muajin e tretë dhe nuk dimë se si është gjendja. Nuk po kemi material të shqyrtojme më dhe është e pafalshme që nëse kemi 30 muaj dhe nuk e kemi së paku një ligj dhe të ulemi të punojmë”, ka thënë Zemaj, teksa u interesua të dijë se a po funksionin Komisioni Ekzekutiv për Shëndetësi dhe nëse i janë bartur Vitisë kompetencat. “Ju jeni larguar në pikun e pandemisë. Ka ardhur një ministër tjetër që për një vit ka mbajtur atë pozitë, e më pastaj është larguar duke e lënë një letër të keqe, duke theksuar se qeveria Kurti ka lënë forma të korrupsionit. Detyra juaj në një institucion privat nuk ka lënë shije të mirë. Këto janë të meta të prodhuara gjatë kësaj kohe”, ka thënë Zemaj.

## Krasniqi viziton Shoqatën e të Burgosurve Politikë

Prishtinë, 14 shkurt - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në kuadër të Javës së Pavarësisë, ka vizituar Shoqatën e të Burgosurve Politikë. "Kam qenë vetëm 15 vjeç kur më kanë burgosur për herë të parë, pasi

kisha bërë betimin si pjesë e grupit të organizuar të ilegalistëve të Ferizajt, 'Shote Galica'. Nga ajo ditë asnjëherë nuk më janë ndarë përndjekjet dhe sfidat", ka thënë Salihe Salihu, ish-e burgosur politike. Krasniqi ka theksuar se rrëfime

të ngjashme kanë me mijëra ish-të burgosur politikë, shqiptarë të Kosovës, të cilët për dekada të tëra kanë vuajtur represionin e vazhdueshëm serb si pasojë e veprimtarisë së tyre për liri. "Falë edhe guximit dhe veprimtarisë së tyre sot jemi në prag të festimit

të 15-vjetorit të pavarësisë së shtetit tonë, në të cilin kemi nevojë më shumë se kurrë të besojmë, mos ta braktisim dhe të punojmë çdo ditë për të. Kjo shoqatë, e cila ka mijëra anëtarë ish-të burgosur politikë, meriton kushte më të mira dhe

mbështetje të vazhdueshme dhe të garantuar nga shteti. Vetëm duke ndërtuar një shtet të fuqishëm dhe prosperues, do ta jetësojmë edhe idealin shumëvjeçar të atyre që sakrifkuan gjithçka për Kosovën", ka thënë Krasniqi.



## Osmani: Kosova dhe Shqipëria janë të përcaktuara për rrugën evropiane



PRISHTINË, 14 SHKURT - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të martën në takim një delegacion parlamentar nga Shqipëria, i përbërë nga anëtarë të Komisionit për Integrim Evropian, i kryesuar nga Jorida Tabaku. Në takim u diskutua për mundësitë e fuqizimit të koordinimit në politikën e jashtme, në funksion të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, me fokus të veçantë në sferën e integritimit evropian. Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova mund të përfitojë nga përvoja e Shqipërisë në procesin e integritimeve evropiane, ndaj ka kërkuar të vazhdojë edhe më tej të jetë zë i fuqishëm i Kosovës.

Sipas presidentes Osmani, Kosova llogaritet në mbështetjen e Shqipërisë në rrugën euroatlantike, në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës, por edhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Presidentja Osmani ka theksuar se Kosova dhe Shqipëria ndajnë të njëjtat vlera dhe se janë të përcaktuara për rrugën evropiane dhe të përkushtuara për paqe e stabilitet. Delegacioni parlamentar nga Shqipëria i ka dhënë mbështetje Kosovës në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës dhe ka bërë me dije se do të jetë krah Kosovës në proceset integruese, duke dhënë maksimumin nga përvoja e tyre.

## Lirohen nga akuza tetë të akuzuarit për mashtrime me subvencione

PRISHTINË, 14 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj tetë të akuzuarve për mashtrim me subvencione. Aktgjykimi ndaj të akuzuarve u shpall të martën nga gjykatësi Adnan Kamberi,

raporton “Betimi për Drejtësi”. Sipas aktgjykimit, të akuzuarit u liruan nga akuza sepse nuk është provuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë ngarkuar, ndërsa traktori i sekuestruar përkohësisht i kthehet të

akuzuarit Berisha. Gjykatësi Kamberi ka thënë se shpenzimet e procedurës bien në barrë të gjykatës, kurse kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15-ditësh pas pranimi të tij.



## Pak të interesuar për zëvendësimin e policëve në veri

PRISHTINË, 14 SHKURT - Rreth 140 pjesëtarë të komuniteteve joshumicë aplikuan në konkursin e Policisë së Kosovës për punësimin e punëtorëve të rinj në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe. Prej tyre, 136 i plotësojnë kushtet dhe do t'i nënshtrohen testit me shkrim më 20 shkurt. Këtë e konfirmon për “Radion Evropa e Lirë” zëvendësdrejtori i përgjithshëm i policisë, Dejan Janković, por pa saktësuar nëse në mesin e kandidatëve ka edhe pjesëtarë të komunitetit serb.

Çështja e pjesëmarrjes së serbëve në policinë në veri të Kosovës është aktuale qysh nga nëntori i vitit të kaluar, kur mbi 550 prej tyre kanë dhënë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i

riregjistruar makinat me targa serbe me targa të Kosovës.

Konkursi për pranimin e policëve të rinj u hap në fillim të janarit, ndërsa më pas u shty deri më 10 shkurt. Ndërkohë nisi edhe një fushatë “për rëndësinë e konkursit”, e cila u mbështet nga zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës, të institucioneve ndërkombëtare dhe të ambasadave. “Bashkojuni Policisë së Kosovës dhe kontribuoni në sigurinë e komunitetit tuaj. Përfitoni nga kjo mundësi. Është në të mirë të komunitetit tuaj dhe juve”, ishte mesazhi i kreu të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lars-Gunnar Wigemark, i publikuar në rrjetet sociale në kuadër të fushatës.

Tash për tash nuk dihet se si do të plotësohen mbi 400



pozita të lira në Drejtorinë e Policisë së Kosovës për rajonin e veriut - përmes konkurseve të reja apo rikthimit të atyre që kanë dhënë dorëheqje.

REL iu drejtua Ministrisë së

Punëve të Brendshme të Kosovës me këtë pyetje, por nuk mori përgjigje. As Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it nëse ka ndonjë plan për ta motivuar komunitetin serb që të bëhet

pjesë e Policisë së Kosovës, apo nëse do të lejojë që ata që kanë dhënë dorëheqje, të kthehen.

Drejtoria e Policisë e Kosovës për rajonin e veriut ka katër stacione policore dhe tri nënstacione të cilat mbulojnë qytetet: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, si dhe mbi 175 fshatra në territorin e këtyre katër komunave.

Këto stacione policore, aktualisht, nuk funksionojnë me kapacitet të plotë, për shkak se nuk kanë mjaft staf dhe personel administrativ. Megjithatë, dhjetorin e kaluar Kosova dërgoi njësi nga jugu në komunat në veri, të cilat, përkohësisht, kujdesen për sigurinë. Bëhet fjalë kryesisht për policë të komunitetit shqiptar, prania e të cilëve kundërshtohet nga popullata vendase.

## Ironizon Bajrami: Po ‘luftohet korrupsioni’, mbi 9 milionë euro i falen Ferronikelit



PRISHTINË, 14 SHKURT - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka reaguar të martën ndaj një vendimi të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) për, siç ka shkruar ajo në “Facebook”, “faljen e mbi 9 milionë euro Ferronikelit, obligime këto ndaj shtetit rentë minerare”. “9 milionë euro për Ferroniklin. Po thonë po ‘luftohet korrupsioni’, që nja fakt tjetër qysh 51%-shi po lufton korrupsionin: Bordi Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,

KPMM, i zgjedhur nga 51% me datë 6 dhjetor 2021, ka marrë vendim të i falë Ferronikelit (kompani kjo 100% private) 9,019,979.44 euro obligime ndaj shtetit rentë minerare”, ka theksuar Bajrami.

Ajo ka thënë se Bordi i KPMM-së me datë 31.05.2022 e ka njoftuar Ferronikelin për detyrimin prej 9,019,979.44 milionë euro për rentë minerare, mandej me datë 29.08.2022 pendohet dhe nxjerr një vendim tjetër për ta liruar Ferronikelin nga ky obligim. “Shkarkimi i këtij Bordi ishte në rend dite në

seancën e 2 shkurtit, por u largu nga rendi i ditës për procedurë dhe për çudi në seancën e ardhshme nuk është në rend dite, d.m.th. përkundër fakteve të ditura ky bord vazhdon të jetë në detyrë me kompetenca të plota. Ky Bord sigurisht do të shkarkohet nga Kuvendi, por dëmi tashmë është bërë, tani shteti do të sorollatet nëpër gjykata duke kontestuar vendimin e vet/Bordit të KPMM-së në favor të Ferronikelit. Garant komitetet e LVV-së, e cilësojnë këtë si ‘luftë kundër korrupsionit’, ka theksuar Bajrami.


## Osmani: Vendosmëria e ushtarëve të FSK-së për të shpëtuar jetë, ngjallë shpresë në këtë tragjedi

PRISHTINË, 14 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka falënderuar Forcën e Sigurisë së Kosovës për ndihmën që po ofron në zonat e prekura nga tërmeti në Turqi. Osmani ka thënë se trimëria dhe vendosmëria e palëkundur e ushtarëve të Kosovës për të shpëtuar jetë nga rrënojat ngjallë shpresë në këtë tragjedi,

e cila ka shkaktuar trishtim në çdo cep të botës. “Trimëria dhe vendosmëria e palëkundur e ushtarëve tanë për të shpëtuar jetë nga rrënojat e tërmeteve shkatërruese në Turqi ngjallë shpresë në këtë tragjedi që ka shkaktuar trishtim në çdo cep të botës. Heroizmi i treguar nga Forca jonë e Sigurisë na kujton dhembshurinë dhe

solidaritetin e popullit tonë për të qëndruar krah për krah me miqtë tanë në kohë sfiduese. Faleminderit FSK që në tërë këtë dhimbje e trishtim, na jepni shkëndija shprese. Jemi krenar me ju!”, ka shkruar ajo në “Facebook”.

Numri i të vdekurve nga tërmetet në Turqi dhe Siri ka shkuar mbi 37 mijë.



## 15-vjetori i Pavarësisë së Kosovës, Reka me fjalë rasti para Këshillit të Qytetit të Nju-Jorkut

NJU-JORK, 14 SHKURT - Shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ambasadori Blerim Reka, ka mbajtur fjalim para Këshillit të Qytetit të Nju-Jorkut me rastin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. "I nderuar t'i drejtohesha Këshillit të qytetit të Nju-Jorkut me rastin e 15-vjetorit

të pavarësisë së Kosovës, dje në mbledhjen e veçantë kushtuar këtij përvjetori të rëndësishëm të shtetësisë sonë. Seancën e këshillit të qytetit të Nju-Jorkut e hapi dhe e udhëhoqi veprimtari ynë Mark Gjonaj, ish-këshilltar i Nju-Jorkut ku folën edhe këshilltarët David Carr, Robert Holden e Marjorie Velaszquez", ka shkruar Reka

në "Facebook". Pas ndarjes së mirënjohjeve për veprimtarët shqiptaro-amerikanë, u shfaq një program kulturor me këngë dhe valle të Kosovës. "Këshilli i qytetit të Nju-Jorkut, kështu iu bashkua festimit të ditëlindjes së 15 të Republikës së Kosovës. Kryeqendra e botës frymoi me Kosovën", ka shkruar ambasadori Reka.



## Aksioni i PSD-së para qeverisë: Për dy vjet qeverisje nuk ia kanë ba vijë

Prishtinë, 14 shkurt - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur një aksion simbolik në dyvjetorin e qeverisë Kurti II. PSD-ja ka thënë se për dy vjet qeveria nuk ka bërë asgjë. "Rrahje gjoksi e rritje e mendjes; shumë fjalë, shumë numra, shumë shifra. Para dy vjetëve na thanë se ndodhi diçka e madhe, e jashtëzakonshme. A e dini çfarë ndodhi para dy vjetëve? Bash asgjë. Sot është 14 shkurti. Sot kalon gjysmëmandati i kësaj qeverie. Kjo qeveri nuk e ka pasur programin transformues. Edhe sikur ta zbatonte s'do të bëhej nami. Problemi është që këta as nuk kanë filluar. Nuk ia kanë ba vijë", është theksuar në mesazhin e PSD-së. Sipas PSD-së, i kanë premtuar

160 çerdhe të reja, nuk është asnjë dhe nuk ia kanë bërë vijë. "I kanë premtuar 2 000 banesa për çifte të reja. Nuk kemi as gurthemel. Nuk ia kanë ba vijë. Kanë premtuar pesëfishimin e numrit të inspektorëve të punës. Nuk ia kanë ba vijë. Kanë premtuar rregullim të shëndetësisë. Kanë thënë s'do të ketë mungesë barnash, dhe do të fillojnë sigurimet shëndetësore. Nuk ia kanë ba vijë. Gjendja është veç më e rëndë. Për ditën e dashurisë, për ata që dashurinë e dinë si ngjarje, ngjarja përcjellët me konsekuenca, ajo e ka subjektin e vet besnik. Kurrëgjë ma keq s'ka mundur t'i ndodhë ditës së dashurisë se sa ky shpërfytyrim kolosal, kjo gënjeshtëri e madhe", ka njoftuar PSD-ja.



## Kosova strehon edhe një gazetare afgane



PRISHTINË, 14 SHKURT - Në Kosovë është strehuar edhe një gazetare afgane, duke e çuar në pesë numrin e gazetarëve afganë që do të qëndrojnë në vend për dy vjetët e ardhshëm. Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) njoftoi se gazetarja Nadia Gulabzada ka mbërritur në Prishtinë mëngjesin e së martës. Më 28 dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Kosovës miratoi buxhetin prej 30 mijë eurosh për strehimin e gazetarëve afganë. Ekzekutivi tha se Kosova do të pranojë pesë gazetarë nga Afganistani dhe ata do të mund të qëndrojnë

në shtet për dy vjet. Dy javë më parë në Kosovë mbërritën edhe gazetarët Amina Omid, Ahmad Shaker, Nimatullah Gholami dhe Raifullah Nikzad. Të pesë gazetarët do të strehohen në kuadër të programit "Gazetarët në Rezidencë - Kosovë". Qeveria e Kosovës tha se do të ndajë edhe mjete shtesë për t'iu ofruar strehim, pagë mujore, sigurim shëndetësor dhe kushte të tjera gazetarëve afganë. Përzgjedhja e gazetarëve që strehohen në Kosovë u bë nga Federata Evropiane e Gazetarëve dhe Qendra Evropiane për Liri të Shtypit

dhe Medies në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Kosova, gjithashtu, ka strehuar disa gazetarë ukrainas dhe u ka ofruar kushte të njëjta sikurse atyre afganë, pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt 2022. Në gusht të vitit 2021, kur talibanët rimorën pushtetin në Afganistan, Kosova pranoi kërkesën e Shteteve të Bashkuara për strehimin e refugjatëve afganë, që ishin të rrezikuar nga ky regjim. Kosova ka strehuar përkohësisht 1 893 refugjatë afganë dhe më pas ata janë dërguar në ShBA dhe në shtete të tjera.

## Kosova, i vetmi shtet në Evropë pa gazetë

PRISHTINË, 14 SHKURT - Profetori universitar Milazim Krasniqi ka thënë se Kosova është i vetmi shtet pa gazetë. "Po të pyetesha unë, një nga kriteret për integrim në Bashkimin Evropian, do ta vendosja kriterin që vendi me një milion e gjysmë banorë të ketë së paku tri gazeta ditore. Pse?

Sepse vendi që ka shtatë universitete publike e pa asnjë gazetë ditore, thjesht nuk është vend. Nëse në 100 000 studentë nuk gjenden 10 000 lexues, pyetja shtrohet se sa ata janë studentë. Ndërsa për profesorët kriteri duhet të jetë më rigoroz: nëse nga 3 000 profesorë universitarë nuk

gjenden 2 000 lexues të rregullt të gazetave ditore, pyetja shtrohet sa ata janë profesorë. Sigurisht e kam fjalën për gazeta të mirëfillta, jo për kobure të partive ose grupeve kriminale siç kanë qenë disa nga gazetatat e shkuara", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



# Prodhimet serbe përballë bojkotit në Kosovë



Prishtinë, 14 shkurt - Produktet me origjinë nga Serbia vazhdojnë të zënë një hapësirë të madhe në shportën e konsumatorëve në Kosovë edhe pse kohën e fundit janë bërë më të shpeshta thirrjet për bojkotimin e tyre. Gjatë vitit 2022 Kosova importoi nga Serbia produkte në vlerë prej 371.6 milionë eurosh, ndërsa eksportoi atje gjashtë herë më pak, përkatësisht 60.7 milionë euro produkte.

Në rrjetin social "Facebook" ka kohë që është formuar një grup me emrin "Mos bli prodhime serbe", i cili numëron mbi 110 mijë anëtarë. Kjo thirrje duket se ka ndikuar te disa qytetarë që ta verifikojnë vendin e origjinës së produktit para se ta blejnë atë. "Po gjejmë produkte vendore, po ashtu ka produkte nga shtetet e tjera. Nuk kemi nevojë t'i marrim të Serbisë", thotë Hasime Maliqi, banore në Prishtinë, për "Radion Evropa e Lirë".

Ajo tregon se në shtëpinë e saj nuk ka asnjë produkt të Serbisë - nisur nga pijet freskuese deri te mëlmesat. "Si ta shoh flamurin në raft, nëse është i Serbisë, nuk afrohem as ta këqyr", thotë ajo.

Bashkëqytetarja e saj, Valbona Olluri, thotë se ka vepruar ngjashëm. "Ne nuk i blejmë këto [produkte] të Serbisë. S'e përdorim më vajin e Serbisë. Po e blejmë të Kosovës apo të ndonjë shteti tjetër. Edhe produktet e tjera në kuzhinë... vetëm vendore ose të ndonjë shteti tjetër", thotë Olluri.

Endrit Binakaj, përkrahës i fushatës online "Mos bli prodhime serbe", thotë se prej

vitesh nuk blen produkte me origjinë nga Serbia. Qëllimi kryesor i tij thotë se është t'i mbështes prodhuesit vendorë. "E kam parë edhe në rrethin tim që është një ngritje e vetëdijes për t'i bojkotuar produktet me origjinë nga Serbia. Kjo po vërehet nga secili prej nesh që frekuentojmë dyqanet, sepse produktet serbe po shiten me zbritje të mëdha, pasi ato kanë mbetur në raftet e dyqaneve dhe nuk i blen askush", thotë Binakaj për "Radion Evropa e Lirë". Ai dhe mbështetës të tjerë të fushatës thonë se ajo është motivuar nga kundërshtimi politik që Serbia i bën shtetit të Kosovës.

Kosova ka shpallur pavarësinë në shkurt të vitit 2008, por Serbia nuk e njeh ende atë. Dy vendet janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve që nga viti 2011. Në Kosovë ka pasur shpesh thirrje për bojkotimin e produkteve serbe, përfshirë edhe nga partitë opozitare, ndërsa e fundit "Mos bli prodhime serbe" është aktualizuar në fillim të muajit dhjetor, pak kohë para festave të fundvitit, kur zakonisht ka rritje të ndjeshme të sasisë së produkteve që blejnë qytetarët. Por, përkundër saj, të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se vlera e importit nga Serbia ka qenë më e madhe në muajin janar të këtij viti sesa në janar të vitit 2022.

Sipas tyre, këtë janar vlera e produkteve të importuara serbe ka qenë 17 milionë e 804 mijë euro, krahasuar me janarin e kaluar kur ka qenë 16 milionë e 311 mijë euro.

Se cili ka qenë ndikimi i

fushatës "Mos bli prodhime serbe" më vonë, mbetet të shihet por, sipas njërit prej mbështetësve kryesorë të saj, Burim Piraj, njëherësh pronar i fabrikës së mishit "Meka" në Prizren, qytetarët në masë të madhe janë duke refuzuar blerjen e prodhimeve nga Serbia. "Fushata jonë ka ndikuar që të rritet patriotizmi ekonomik në vend, i cili na ka munguar për shumë kohë dhe po reflekton tani te prodhuesit vendorë... pasi produktet e tyre po shiten më shumë", thotë Piraj për "Radion Evropa e Lirë". Në qytetin e Ferizajt dyqani ushqimor "Plus Center" ka vite që nuk mban në raftet produkte ushqimore me origjinë nga Serbia. Në këtë biznes thonë se largimin e këtyre produkteve e kanë bërë për ta "edukuar" konsumatorin që të konsumojë produkte vendore. "Artikuj vendorë ka sa të duash, mall ka sa të duash, ushqime vendore ka sa të duash", thotë Remzi Bytyqi, menaxher në këtë biznes. "Prej se është aktualizuar fushata 'Mos bli prodhime serbe' e kemi një fluks më të madh të konsumatorëve. Viti i kaluar ka qenë vit që e kemi përmbyllur me një sukses shumë të madh", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

## A janë rritur çmimet e prodhimeve vendore?

Disa qytetarë, të intervistuar nga "Radio Evropa e Lirë", thonë se kanë vërejtur rritje çmimesh. "Ne nuk po i blejmë të Serbisë, por është fakt se janë

shtrenjtuar produktet vendore, si: vaji, mielli, vezët etj.", thotë Valbona Olluri. "Të gjitha produkteve u është rritur çmimi, por së paku këtyre vendoreve nuk duhet t'u rritet aq shumë", thotë edhe Hasime Maliqi.

Ankesa për rritje çmimesh, të dëshmuara me fotografi, janë postuar edhe në "Facebook", në grupin "Mos bli prodhime serbe".

Binakaj, përkrahës i kësaj fushate, thotë se prodhuesit nuk duhet ta shfrytëzojnë situatën për të përfituar "në kurriz të konsumatorëve". "Nuk është një veprim i mirë i bizneseve që ta shfrytëzojnë rastin, t'i rritin çmimet dhe ta dëmtojnë konsumatorin", thotë Binakaj.

Remzi Bytyqi nga kompania "Plus Center" pranon se ka parë komente të shumta të qytetarëve që ankohen për rritje të çmimeve të produkteve vendore, por ai thotë se prodhuesit vendorë, në disa raste, kanë qenë të detyruar t'i rritin çmimet për shkak se është shtrenjtuar lënda e parë që ata e importojnë për prodhime të caktuara. Sipas tij, prodhuesit vendorë mund të gjejnë zgjidhje për ta ruajtur "trendin e mirë" të prodhimeve të tyre. "Të punojnë me një marzhë më të vogël të fitimit që të mos zhgënjehen qytetarët", thotë Bytyqi.

Ngjashëm shprehet edhe Burim Piraj, i cili është edhe vetë prodhues. "Ne po mendojmë se kjo tezë e shtrenjtimit të produkteve vendore është lansuar nga ato subjekte, të cilave nuk u

konvenon që të mos blihen produktet serbe, pra që ta dekurajojnë qytetarin kosovar nga fushata jonë", thotë Piraj, pa specifikuar se për kë e ka fjalën.

## Inspektorati i Tregut: Shitësit po mashtrojnë me flamujt e origjinës

Inspektorati i Tregut, autoritet në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë (MINT), thotë për "Radion Evropa e Lirë" se konsumatorët ndodh që mashtrohen në lidhje me produktet serbe, pasi shitësit vendosin etiketa të rreme në produkte. "Në rastet më të shpeshta është duke u vendosur etiketa e flamurit të shteteve të Evropës në produktet që janë me origjinë të shteteve fqinje, përfshirë edhe Serbinë", thonë nga ky inspektorat.

Për këto lloje mashtrimesh gjatë vitit të kaluar atje janë dorëzuar 1 200 ankesa, ndërsa gjatë janarit të këtij viti qytetarët kanë dërguar në këtë institucion 119 ankesa. Nga Inspektorati i Tregut nuk japin numër të gjobave apo masave të shqiptuara, por thonë se "është një numër i lartë i rasteve të identifikuara për mashtrim me vendin e origjinës së produktit".

Përveç nga Serbia, Kosova importon edhe nga vendet e tjera të Ballkanit, nga Bashkimi Evropian, nga Turqia e të tjera, por deficitin tregtar për të është shndërruar në fenomen tash e sa vjet.



# Kishat ortodokse shqiptare dhe uzurpimi i tyre nga shteti serb (2)

(Sllavizimi i kishave shqiptaro-bizantine të Kosovës projekte të hershme të Serbisë)




Shkruan: Faton B. MEHMETAJ

Në Shqipëri Shën Kolli ishte shenjtori më i popullarizuar dhe ka më shumë kisha e institucione fetare pas Zojës së Bekuar, ndërsa në Kosovë është vetëm një kishë kushtuar këtij shenjtori, në Janjevë, vendbanim i cili për herë të parë zihet në gojë në vitin 1303 nga Papa Benedikti XII si qendër katolike. Megjithatë, shumë familje katolike anembanë Kosovës (Selmani, Mrijaj, Gjinaj, Nikollaj, Përgjoka, Karrica, Paloka, Gojani, Curri, Spaqi, Gjonllëshaj) e festojnë ditën e Shënkolllit si festë familjare. Numri i shqiptarëve ortodoks nuk është i vogël, ky numër sillet rreth 4.000.000, prej tyre 1.000.000 jetojnë në Shqipëri dhe Greqi, 2.000.000 jetojnë në Itali, enklava me shqiptar ortodoks ka edhe në Bullgari, Ukrainë, Rusi etj. Një numër i madh i shqiptarëve ortodoks ishte edhe në Maqedoni por që sistemi sllavo-komunist i asimiloi gradualisht por që pas fillimit të epokës së demokracisë ata kanë filluar të kthehen në identitetin e vjetër (në shqiptar ortodoks). Në Greqi jetojnë rreth 3 milionë "arvanit", që banojnë në 696 katunde dhe 15 krahina. Edhe në Mal të Zi kishte shumë shqiptarë ortodoks, një pjesë e madhe e Malit të Zi. Brenda e këtyre kishave që dekoruar me simbolizmin tradicional ortodoks shqiptar dhe perandorak të kohës, të mbizotëruar nga shqiponja dykrerëshe e trashëguar nga Justiniani, e që nën sundimin otoman

pas Luftës së Kosovës, kur serbët qenë në aleancë me turq sikurse tash që janë rreshtuar me rus, simbolizmi dhe shkrimi që ndërruar sistematikisht. Me 3 mars 1878, një traktat paqe u nënshkrua nga ana e ruse dhe perandoria otomane në Shën Stefan që përfundoi Luftën ruso-otomane të viteve 1876-78. Si pasojë e kësaj marrëveshjeje në dëm të shqiptarëve autokton, filloj një egzod i madh nën trysinë e ushtrisë serbe, me tërheqjen e popullatës shqiptare nga Dardania Lindore (Regjioni i Toplicës me qendër urbane në Nish). Rreth 600 vendbanime shqiptare qenë djegure rënur nga barbarizmi i ushtrisë serbe dhe ruse, duke e copëtuar dhe sakatosur etnikumin shqiptar. Sipas akademikut Josip Rogliq i cili thotë se: "E tërë terminologjia geomorfologjike dhe emrat geografik të Gadishullit Ilirik i takojnë gjuhës Ilire". Madje Iliria ka edhe martirët e parë të krishterimit, Florin dhe Laurin nga Ulpiana, kryeqendra e Dardanisë afër Prishtinës të cilët u vranë gjatë sundimit të Hadrianit (117-138). Në mesin e emrave të të shenjtëve që kanë mbetur si emër-vende është edhe Mitrovica, që lidhet me shenjtërinë e famshme Shmitrin (Shën Mitrin-Shën Dhimitri) që u martirizua në Simium të Dardanisë Veriore ose Moezisë, ku ishte selia e Perandorisë Romake rreth dyqind vjet. Kisha e Shën Dhimitrit në Dardanië veriore, që tani mbanë emrin Mitrovica me gjasë u shkatërrua me depërtimin e hordive barbare rreth shekullit 11. Në pjesën qendrore të respublica-Ulpiana, qëndrojnë themelet e Bazilikës, që njihet qysh nga kohërat Romake. Prefekti i Ilirikumit, Leontini themeloi këtë kult duke ngritur për nderë të tij një kishë të madhe në Selanik në shekullin 6-të. Në Gadishullin e Ilirisë janë ngritur më se 200 kisha

për nder të tij. Edhe sot e kësaj dite shqiptarët e festojnë festën e Shmitrit e cila është festë edhe e komunitetit shqiptarë mysliman. Në Deçan me rrethinë festa e Shmitrit festohet nga komuniteti katolik dhe mysliman. Madje në fshatin Belle festa e Shmitrit ishte ndër festat kryesore të vitit. Meqenëse jemi tek ortodoksizmi shqiptarë këtu një vend të madh e zë Konstandini i Madh i cili e ktheu perandorinë pagane në perandori krishtere, kurse Justiniani i Madh ia dha trajtën përfundimtare duke ndërtuar Shën Sofinë në Konstandinopojë. Krishterimi ishte bërthama e jetës bizantine, duke nxjerrë fuqinë e saj nga Zoti. Krishti si "Pantikrator" është figura e gjithëfuqishme që vendosej në qendër të kupës. Pra në mesin e figurave të ndritura të Ilirisë është edhe Konstandini i Madh, perandori romak, i cili së bashku me Dioklecionin ndërtoi Konstandinopojën, kryeqendrën e qytetërimit perëndimor për 1.000 vjet. Dimitrije Tucoviçi, Kosta Novakoviçi, Dushan Popoviçi, Dragisha Lapçeviçi, e të tjerë që, gjatë viteve 1912-13, e pranuan hapur dhe u deklaruan botërisht se Serbia e kishte pushtuar Kosovën, madje ata kundërshtuan krimet e llahtarshme të shtetit serb ndaj popullatës së pafajshme civile shqiptare në Kosovë. Për fat të keq, këto krime u përsëritën fill pas Luftës së Parë Botërore, më 1918-1919, pastaj gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, në fund të Luftës së Dytë Botërore (1944-1945), pastaj gjatë viteve 1946-1966, e rishtazi edhe gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar (1989-1999), u pa haptazi se Serbia e donte Kosovën pa shqiptar, për këtë arsyeje ushtroi gjenocid, vrasje në masë dhe shkatërroj çdo gjë që ishte shqiptare.

Arbanasit-shqiptarët e pranuan krishterimin qysh në shekullin e parë, kur komunitetet tjera nuk ekzistonin apo ishin pagan. Kisha serbe dhe ajo greke bënë një luftë të gjatë dhe pa kompromis kundër popullit shqiptarë gjatë gjithë historisë e që kjo luftë vazhdon edhe sot. Në këtë kontest Justiniani i Madh, emri i vërtet i tij (Petrus Seblatius), zmbrapsi depërtimin e barbarëve sllav në vitet 550-551 të cilët si barbar që ishin shkaktuan dëme të mëdha. Siç dihet aktiviteti kishtar i Justinianit të Madh veçohet me mësimin ortodoks, që është dëshmuar me ngritjen e kishave dhe shumë vendeve të bamirësisë. Ai është i njohur për riorganizimin administrativ dhe kishtarë por edhe për mbishkrimin e kodifikimit të ligjeve të njohura si Codex Justinianus (534). Këtu duhet përmendur një të dhënë të studiuesit P.Slijepçeviq i cili mes tjerash thotë: "Serbët nuk kanë pasur fare traditë të vetën as në



Kisha e Shën Spasit (Shpëtimtarit), ose kisha e gogëve (vllëhëve), si thotë populli. Kjo ka historinë e saj. Serbët e kanë djegur disa herë në kohën e sundimit, se vllëhët nuk pranonin gjuhën serbe në kishë. Ka atje disa varre të vjetra me kryeshkrime greqishte që mund të na shërbejnë si dokumente historike, për të vërtetuar se pjesa më e madhe e popullsisë serbe e Prizrenit, është në realitet, një popullsi shqiptaro-rumune e serbizuar përmes kishës dhe e cila dikur, ka dashur ta rrojë jetën e vet kombëtare. Lagjja e kolonisë së Cincarëve (Gogëve, Arumunëve), të cilët kanë qenë kryesisht kalldrëmshinj, muratorë, kallajshinj dhe kazanshinj. (Mtrush Kuteli, cituar sipas Salajdin Krasniqit, Prizreni udhëtim nëpër kohë).

ndërtimtari as në artin e pikturës" pra të zbukurimit të kishave. Kështu, në qytetin e vjetër të Ohrit, në vitin 1295, ishte fisniku shqiptar dhe gjenerali i ushtrisë bizantine Progon Zguro i cili e ndërtoi njërën nga kishat më të bukura të Ohrit-Kishën e Shën Klementit, të njohur si Nëna e Shenjtë e Zotit-Perivleptos. Progon Zguro ishte dhëndër i perandorit bizantin Andreamakut të II-të Paleolog. Zguroja ishte baxhanak me mbretin serb Millutin Nemanjiq, i cili gjithashtu ishte i martuar me femijë, në moshën tetëvjeçare, ndërsa Millutini ishte plak dhe ishte martuar tri herë më parë. Millutini kishte verbuar djalin e vet Stefanin "pa kurrfarë hetimesh gjyqësore", që u ngrit kundër të atit për të marrë fronin. Stefanin e përmbysi biri i tij Dushani, duke u ngritur në fortesën e Zveçanit, dhe kështu me radhë. Edhe pse ndodhi kështu kisha ortodokse të gjithë këta i shpalli të shenjtë".

Mirëpo në këto kohëra shumë prijës shqiptar siç u pa edhe më lartë e kishin mbështetjen e

udhëheqësve me ndikim të Konstandinopojës. Kështu që në vitin 319-të, tre vëllezërit Muzakaj, Mentuli "kont i Këlcyres", Andrea "marshall i mbretërisë së Arbërisë dhe Teodori "protosebast" ishin bashkuar në një koalicion të gjerë kundër mbretit të Serbisë, Uroshit të II-të. Ky koalicion që drejtuar nga Papa Joani XXII. Në vitin 1330 Adrea u bë i pari i shtëpisë së Muzakajve. Ai kishte fituar aq famë e ndikim sa që perandori i Bizantit, Andronik II Paleolog, i dha atij titullin e lartë të despotit. Pas rënës së Perandorisë Bizantine, Andrea Muzaka i theu forcat e kralit serb Vukashin në malet e Peristerit dhe po atë kohë ai rrembeu Mark Kraleviqit qytetin e Kosturit. Në këtë qytet Muzakajt ngritën një kishë, Shën Athanasin e Muzakajve, të zbukuruar me afreske shumë cilësore, e cila ruhet ende sot. Siç u tha më lartë, afër Prishtinës, në fshatin Graçanicë, gjendet manastiri i vjetër po më këtë emër, ku ka qenë selia e arqipeshkvit të Lipjanit qysh në kohën e sundimit të Bizantit në këto vise dhe ishte ndërtuar në vitin 930. (Vijon)



Shqiptarët duke festuar festat e vjetra të motmotit në Kishën e Deçanit

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com




## U mbajt seminari për licencimin e klubeve për garat evropiane

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është mbajtur seminari për licencimin e klubeve për garat e UEFA-s për edicionin garues 2023/24, në të cilën morën pjesë zyrtarët e klubeve të Albi Mall Superligës. Në këtë

seminar menaxheri i licencimit, Bajram Shala dhe eksperti financiar i FFK-së, Indrit Canolli, i njoftuan klubet për ndryshimet që ka pësuar Rregullorja e UEFA-s për licencim në garat evropiane si dhe për kriteret që duhen plotësuar fazë pas

faze deri në finalizimin e plotë të këtij procesi. Kontribut në diskutimet rreth kriterëve të ndryshme të këtij procesi e dhanë edhe anëtarët e Komisionit të Licencimit të Shkallës së Parë, Naim Havolli, Safet Berisha dhe Jusuf Tortoshi. "Tashmë është

krijuar një përvojë e mirë për përmbushjen e kriterëve për licencim dhe kryesisht klubet tona kanë arritur ta kalojnë me sukses këtë proces në vitet e mëparshme. Procesi i licencimit të klubeve do të përmbyllet deri në muajin maj. Një seminar i këtillë do të



mbahet edhe të mërkurën me klubet e Sigal Superligës së femrave", thuhet në njoftimin e FFK-së.

## Sot fillon Festivali i Basketbollit në Rahovec

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Nga 15 deri më 19 shkurt palestra "Mizahir Isma" do të jetë arenë e superndeshjeve të basketbollit. Me moton "n'Rahovec e kem konakun" do të zhvillohet "Final 8" i Kupës së Kosovës. Tetë skuadrat më të mira të Prince Caffë Superligës, dy të femrave dhe katër të Ligës së Parë të Meshkujve, do të garojnë për trofetë e çmuar në basketbollin e Kosovës. Ndeshje interesante priten në parket dhe atmosferë sportive në tribuna, duke e bërë madhështore këtë garë ashtu si e meriton. Kjo ngjarje zhvillohet gjatë festës së Pavarësisë së Kosovës, duke e madhështuar edhe më shumë "Final 8". "Final



8" hapet me gjysmëfinalen e Ligës së Parë mes Boras dhe Istogut. Fituesi i kësaj ndeshje në finale e pret fituesin e takimit New Basket-Drita që zhvillohet të

enjten. Trepça-Vëllaznimi dhe Peja-Rahoveci janë dy superduele që zhvillohen të mërkurën, ndërsa fituesit e këtyre ndeshjeve përballen në gjysmëfinale.

### Orari

**Të mërkurën takohen:**  
Ora 14:00 Bora - Istogut (Liga e Parë e Meshkujve)  
Ora 17:00 Trepça - Vëllaznimi Grupi D  
Ora 20:00 Peja - Rahoveci Grupi A

**Të enjten takohen:**  
Ora 14:00 New Basket - Drita (Liga e Parë e Meshkujve)  
Ora 17:00 Sigal Prishtina - Bashkimi Grupi B  
Ora 20:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni Grupi C

**Të premten takohen:**  
Ora 14:00 Ndeshja finale - Liga e Parë  
Ora 17:00 Gjysmëfinalja I Grupi A - D  
Ora 20:00 Gjysmëfinalja II Grupi B - C

**Të dielën takohen:**  
Ora 14:00 Finalja e Kupës së Kosovës për femrat  
Ora 17:00 Finalja e Kupës së Kosovës

## Sonte Liga e Kampionëve sjell përballjet Dortmund - Chelsea dhe Club Brugge - Benfica

### "Epoka e re"

**DORTMUND, 14 SHKURT** - Përballja e parë në mes të Borussia Dortmundit dhe Chelseat zhvillohet të mërkurën mbrëmë në "Westfalenstadion", teksa dy skuadrat kanë synime të mëdha për t'u kualifikuar në raundin tjetër të Ligës së Kampionëve. Dortmundi kaloi fazën e grupeve, pasi përfundoi i dyti në Grupin G pas Manchester Cityt, ndërsa "Blutë" e Londrës ishin të parët në Grupin E, para AC Milan, Red Bull Salzburg dhe Dinamo Zagreb. Dortmund aktualisht ndodhet i treti në tabelën e Bundesligës dhe mbetet në një garë të ashpër për titullin e kampionit, me vetëm tetë pikë që ndajnë gjashtë skuadrat e para me 14 ndeshje të



mbetura deri në fund të kampionatit. "Westfalenstadion" është bërë një fortesë për ekipin gjerman në Ligën e Kampionëve, pasi Dortmundi ka humbur vetëm katër nga 21 ndeshjet e fundit në shtëpi në këtë kompeticion, por ato tri humbje

i ka kundër skuadrave angleze. Dortmundi kundër ekipeve angleze ka dështuar të fitojë në asnjërën prej dhjetë ndeshjeve të fundit, duke barazuar dy herë dhe pësuar plot tetë herë. Fitorja e tyre e fundit kundër një skuadre angleze daton në mars të vitit

2016, kur sulmuesi aktual i Chelseat, Pierre-Emerick Aubameyang, shënoi dy gola në fitoren 2-1 kundër Tottenham Hotspurit në Ligën e Evropës. Pavarësisht kësaj, Dortmundi në këtë edicion arriti të jetë në grup para Sevilës dhe Kopenhagës dhe tani do të synojë ta eliminojë Chelsean. Ndërsa Graham Potter si trajner i Chelseat ka fituar vetëm tri herë në 14 ndeshjet e zhvilluara dhe kjo mund të bëjë që ai shumë shpejt ta humbasë punën e tij. Shpresat e Chelseat për të përfunduar në katërshen e parë vazhdojnë të zbehen pasi aktualisht janë në vendin e nëntë në tabelën e Premierligës dhe 10 pikë prapa Newcastle Unitedit në vendin e katërt. Londinezëve iu duhet ta fitojnë Ligën e Kampionëve nëse dëshirojnë të konkurrojnë sërish

në kompeticionin elitare të klubeve evropiane sezonin e ardhshëm. Kampionët e nisen keq këtë edicion në Ligën e Kampionëve duke pësuar humbje nga Dinamo Zagrebi, por më pas u rikthyen dhe përfunduan në vendin e parë në grup, kurse tash synojnë të marrin rezultat pozitiv dhe në ndeshjen e kthimit ta kenë më të lehtë kalimin e klubit gjerman. Në njëmbëdhjetë ndeshjet e fundit me klubet gjermane si mysafirë, Chelsea ka regjistruar vetëm tri fitore. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër në Ligën e Kampionëve mes Club Brugge dhe Benficës.

**TË MËRKURËN TAKOHEN:**  
21:00 Borussia Dortmund - Chelsea  
21:00 Club Brugge - Benfica

## Sot fillon Kampi i FIBA Gjyqtarëve

**PRISHTINË, 14 SHKURT** - Të mërkurën (sot) fillon Kampi i Gjyqtarëve të Talentuar të FIBA-s. Të përzgjedhur janë nëntë gjyqtarë nga Greqia, Turqia, Hungaria, Kroacia, Sllovenia, Qiproja, Italia dhe

një gjyqtar nga Kosova. Campi do të udhëhiqet nga menaxheri i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA-s, Davorin Nakiq, FIBA Instruktori Nacional nga Maqedonia Veriore, Gjorgji Piperkov dhe

Georgios Tanatzis nga Greqia. Në këtë kamp në orët e paradites (e mërkurë) do të prezantohen ekipet nga interpretimet e rregullave të basketbollit, evaulimi i klipeve, kurse në orët e

pasdites do t'i gjykojnë ndeshjet në kuadër të "Final 8" Kupa e Kosovës në Rahovec. Të pranishëm në punën teorike, si dhe në ndeshjet e Final 8, do të jenë edhe gjyqtarët e FBK-së.



## Kosova A arriti në Alanya, sot përballet me Estoninë

PRISHTINË, 14 SHKURT - Vashat e Përfaqësueses A të Kosovës në futboll kanë arritur në Alanya të Turqisë, ku do të marrin pjesë në turneun miqësor "Turkish National Womens Cup Alanya 2023", ku

pjesëmarrës janë Turqia, Kosova, Estonia, Bullgaria, Honkongu, Jordania, Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Afrika e Jugut, Uzbekistani dhe Zambia, të ndara në 3 grupe. Ekipe të tilla akomoduar

në hotelin "Selene" buzë detit në Alanya. "Dardanet" kanë mbajtur një seancë stërvitore në fitnes pak a shumë për ta relaksuar punën e muskujve nga udhëtimi. Përfaqësuesja A ndeshjen e parë do ta

zhvillojë më 15 shkurt kundër Estonisë në orën 18:00 sipas kohës lokale apo në 16:30 sipas kohës në Kosovë. Ndërkaq në ballafaqimin e dytë Kosova takohet me Honkongun, ndërsa në



ndeshjen e tretë Kosova takohet me Bullgarië.

## Etrit Berisha po kalon nëpër situatën më të vështirë në karrierë

TORINO, 14 SHKURT - Situata e Etrit Berishës te Torino vazhdon të jetë tepër e komplikuar. Klubi italian ka përjashtuar nga ndeshjet portierin dhe emri i tij nuk do të figurojë gjatë përballjeve të mbetura këtë sezon. Madje Eritri nuk do të stërvitet me pjesën tjetër të grupit, por stërvitja e tij do të realizohet veçmas. Ky është kursi që ka ndjekur Torino në lidhje me gardianin e Kombëtares shqiptare, i cili është në situatën më të vështirë të karrierës së tij. Do të luhej miqësorja Shqipëri - Itali dhe në konferencën për shtyp, i pyetur nga gazetarët për situatën në Torino, Berisha shprehu pakënaqësinë e mosaktivizimit dhe rishikimit të pozicionit në muajin janar, pasi deri në ato çaste trajneri Juriç nuk e kishte futur as në Kupën e Italisë, një portier i cili në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar ishte titullar duke fituar vendin me serbin Saviç, shkruan "Panoramasport.al". Ishin këto fjalë që turbulluan ujërat dhe në



merkaton e janarit, Torino kërkonte që ta shiste Eritrin në një ekip tjetër. Rroga e tij sezonale për 800 mijë euro do të ishte një kursim, por nuk pati asnjë transferim dhe nuk u gjet asnjë zgjidhje. Për më tepër, Torino afroi një tjetër portier si Gemelo, të planifikuar si zëvendësuesin e Saviçit. Kështu që Berisha mbeti në klub, ku po jeton me Torinon në një shtëpi, por veçse të ndarë. Një situatë që nuk e ndihmon

aspak ecurinë e tij. Një sezon i tërë jashtë dhe në moshën 33 vjeç, nuk është kushti ideal për në tregun e transferimeve. Për të renduar më tej rrethanat, mungesa në skuadër prej disa ndeshjesh tashmë. Dhe kur mendon se vjet ishte një film krejtësisht ndryshe. Pjesa e dytë e sezonit e pa Berishën si protagonist, ku Vanja u refuzua përkohësisht nga Ivan Juriç dhe Eritri doli në skenë duke nxjerrë në pah të gjithë përvojën e tij.

## Denveri nuk ndalet në Perëndim, humbasin lakersat, Dallasi dhe Miami

PORTLAND, 14 SHKURT - Fitorja e 40 sezonale për ekipin e Denverit, që mposhti me rezultat 112-108 Miamim dhe konsolidoi pozitën në krye të renditjes në Perëndim. Shtatë lojtarë të Denverit realizuan mbi 10 pikë. Sërish më i miri ishte Nikola Jokiqi me 27 pikë e 12 rebounde. Tjetër humbje për lakersat që u mundën me rezultat 127-115 nga Portlandi. Damian Lillard me 40 pikë ishte më i miri për vendasit. Humbja e dytë radhazi për Dallasin që u mund me rezultat 124-121 në



shtëpi nga Minnesota. Edwardsi me 32 pikë ishte lider në fushë për miqtë, i mbështetur mirë edhe nga skuadra, ndërsa loja e Dallasit u fokusua te dyshja Irvng-Donqiq, që së bashku realizuan 69 pikë. Skuadra kampione e Golden States, falë 29 pikëve të Wigginsit e 27 të

Thompsonit, mundi me shifrat 135-126 Washingtonin. Vendimtare në këtë fitore edhe 48 pikët e ardhura nga stoli. Fiton edhe Philadelphia, që mundi me rezultat 123-104 Houstonin me treshen Embiid-Harden Maxey, që së bashku realizuan 77 pikë.

### REZULTATET

Charlotte - Atlanta	144-138
Cleveland - San Antonio	117-109
Indiana - Utah Jazz	117-123
Philadelphia - Houston	123-104
Miami - Denver	108-112
New York - Brooklyn	124-106
Chicago - Orlando	91-100
Oklahoma - New Orleans	100-103
Dallas - Minnesota	121-124
Golden State - Washington	135-126
Portland - Lakers	127-115

### SHKURT

#### Kiqina paraqitet te KF Erzeni

Sulmuesi Sokol Kiqina dhe drejtuesit e Klubit të Futbollit Erzeni kanë rënë dakord që sulmuesi në fjalë të firmosë për një sezon me ekipin e futbollit Erzeni të qytetit të Shijakut. Sulmuesi 20-vjeçar, i lindur në qytetin e Drenasit, së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Llapit në Kosovë, ku ishte transferuar nga skuadra e Feronikelit dhe tashmë për herë të parë do të jetë pjesë e ekipit të futbollit Erzeni në kategorinë "Abissnet Superiore". Sokol Kiqina në pozicionin e tij në fushën e blertë të lojës luan si sulmues i majtë, gjithashtu dhe në majë të sulmit dhe është një vlerë e shtuar në këtë repart.

#### Calhanoglu për tërmetin në Turqi: Nuk është e lehtë të shohësh pamje të tilla

E gjitha bota i ka kthyer sytë kah Turqia dhe Siria pas tërmetit që i goditi këto dy vende. Futbollisti i Interit, Hakan Calhanoglu, i ka përshkruar të tmerrshme pamjet që i ka parë në vendin e ngjarjes përmes mjeteve elektronike, ndërsa i ka falënderuar ata që e ndihmuan atdheun e tij në kohën më të vështirë, ndoshta edhe në histori të tij. "I falënderoj të gjithë shokët e skuadrës dhe familjen e Interit të cilët më kanë qëndruar afër. Kam marrë shumë mesazhe nga tifozët. E kemi përjetuar një tërmet mjaft të fortë. Të shohësh pamje të tilla nuk është e lehtë. Jemi duke bërë gjithçka për t'i ndihmuar këta persona. Duhet të bëhemi bashkë për të dalë sa më shpejt nga kjo situatë", ka thënë Calhanoglu.

#### Hughtoni emërohet trajner i Ganës

Rrugëtimi i Kombëtares ganeze në Botërorin e Katarit ishte shumë i shkurtër pas eliminimit të shpejtë që në fazën e grupeve, eliminim që solli edhe largimin e tekniku Otto Addo nga stoli i "yjeve të zinj" afrikanë. Mirëpo, të martën Federata Ganeze e Futbollit ka paraqitur trajnerin e ri i cili nuk ishte i panjohur për tifozët e afrikanëve. Bëhet fjalë për 64-vjeçarin anglez Chris Hughton i cili më parë ishte këshilltar në Kombëtaren e Ganës dhe tanimë ka marrë në dorë "frerët" e stolit të "yjeve të zinj". Në "ndihmë" të Hughton në "aventurën" e tij më të re do të jenë George Boateng dhe Didi Dramani.

#### Inzaghi: Duhet të kishim fituar ndaj Sampdorias

Trajneri Simone Inzaghi ka mbetur i zhgënjyer me rezultatin që e mori Interi në përballje me Sampdoriam (0-0). Strategu italian ka thënë se skuadra e tij meritoi fitoren në bazë të asaj që krijoi përgjatë gjithë ndeshjes. "Nga kjo sfidë po marr paraqitjen e skuadrës dhe jo rezultatin. Kemi goditur portën 23 herë pa shënuar? Na ka munguar ligësia para saj dhe jemi shumë të zhgënjyer për këtë. Donim të fitonim patjetër dhe duhet të kishim fituar për atë që kemi krijuar. Nuk dua të flas për titullin, pasi duhet të përqendrohemi tek ajo që bëjmë ne, pa u marrë me rivalët. Skuadra pati qasjen e duhur, por na mungoi finalizimi pasi të paktën pjesën e parë duhet ta kishim mbyllur në avantazh", ka thënë Inzaghi.

## Messi ka tri oferta në tavolinë

Fituesi i Kupës së Botës, Lionel Messi, mbërriti te Paris Saint-Germain në gusht të vitit 2021, pasi e kaloi të gjithë karrierën e tij te Barcelona. "Foot Mercato"

raporton se megjithëse zgjatja e qëndrimit të tij në Paris mbetet një opsion, nuk duket se është prioriteti i shtatë herë fituesit të "Topit të Artë". Skuadra nga

MLS, që është nën pronësi të David Beckham, Inter Miami, është duke insistuar në transferimin e tij dhe ka pasur zëra të vazhdueshëm për një

rikthim te Barça. Një lëvizje fitimprurëse në Arabinë Saudite është raportuar po ashtu në kohët e fundit, megjithatë duket se nuk është në plan për

momentin. 35-vjeçari i ka sytë te Kupa e Amerikës në vitin 2024 dhe është i vendosur të luajë në një nivel të lartë për ta mbajtur formën e tij të lartë.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

Në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ. 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese datë 09 Korrik 2020, nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil Të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Neni 35 paragrafi 1 pika 1.2 Ligji 06 /L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Udhëzimi Administrativ (Nr. 01/2019) Për Ndarjen e Përgjegjësisë të SKGJK-së dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën e Apelit (Nr. 06/2021), Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale (Nr. 07/2022), Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatat Themelore dhe Degët e Tyre (Nr. 07/2021); Vendimin KGJK.nr.511/2022, te dates 27 dhjetor 2022 (për miratimin e Planit të Përgjithshëm të personelit për gjyqtar dhe administratën gjyqësore për vitin 2023 që përfshinë të gjitha nivelet e gjykatave) dhe Vendimi i KGJK.nr.28/2023 datë 3 shkurt 2023 ku Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e procedurave për shpalljen publike të konkursit të Jashtëm nr.01/2023, sipas planit të punësimit:

**SEKRETARIATI I KESHILLIT GJYQËSOR TE KOSOVES**

publikon: **KONKURS I JASHTËM Nr. 01/2023**

Nr. Rendor	Gjykata / dega	pozita	Koeficienti	Pozita të lira
1	Gjykata Themelore Mitrovicë	Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media	9	1
2	Gjykata Themelore Pejë	Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media	9	1
3	Gjykata Themelore Prizren	Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa	9	1
4	Gjykata Themelore Prizren	Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa	9	1
5	Gjykata Apelit	Referent	7	1
6	Gjykata Komerciale	Referent	7	6
7	Gjykata Themelore Prizren	Referent	7	3
8	Gj.Th. Prizren - dega Suharekë	Referent	7	1
9	Gjykata Themelore Pejë	Referent	7	3
10	Gjykata Themelore Gjakovë	Referent	7	4
11	Gjykata Themelore Mitrovicë	Referent	7	3
12	Gj.Th. Gjakovë - dega Malishevë	Referent	7	2
13	Gj.Th. Ferizaj - dega Kaçanik	Referent	7	2
14	Sekretariati i KGJK-së	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
15	Gjykata Komerciale	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
16	Gjykata Themelore Prishtinë	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
17	Gj.Th. Prishtinë - dega Podujevë	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
18	Gjykata Themelore Gjilan	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	2
19	Gj.Th. Gjilan - dega Kamenicë	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
20	Gjykata Themelore Pejë	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)	7	1
21	Gjykata Komerciale	Zyrtar për përkthime (Shqip - Anglisht dhe anasjelltas)	7	1
22	Sekretariati i KGJK-së	Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht - Anglisht dhe anasjelltas)	7	1
23	Gj.Th. Prishtinë - dega Grahçanicë	Zyrtar i Teknologjisë Informativë	7	1
24	Gj.Th. Gjakovë - dega Rahovec	Zyrtar i Teknologjisë Informativë	7	1
<b>TOTALI I POZITAVE TË PUBLIKUARA</b>				<b>41</b>

#### Përshkrimi i detyrave të punës

##### Pozita: 1 dhe 2:

**Titulli i pozitës së punës:** Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media;

**Institucioni:** Gjykata Themelore Mitrovicë: - 1 (një) pozitë; dhe Gjykata Themelore Pejë: - 1 (një) pozitë;

**Kategoria Funktionale:** niveli drejtues

**Grada e Vendet të Punës:/ Koeficienti:** koeficienti nëntë (9)

**Lloji i Vendet të Punës:** pa afat të caktuar, me orar të plotë

**Departamenti/Divizioni/Njësia:** Zyra për Informim dhe Komunikim me Media

**Raporton tek:** i përgjigjet dhe i raporton Kryetarit të gjykatës dhe Udhëheqësit të Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

**Vlerësimi i performancës:** bëhet nga Kryetari i gjykatës në koordinim me Udhëheqësin e Zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun në Këshillin Gjyqësor

**Vendndodhja:** Gjykatë

**Procedura e aplikimit:** Konkurs i Jashtëm

**Kohëzgjatja e emërimit:** Pa Afat – përfshi periudhën provuese 1 vit

**Arsyeja e rekrutimit:** plotësimi i pozitave të lira sipas organogramit

**Qëllimi i vendit të punës:** (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Zhvillimin dhe shpërndarjen e komunikatave për të informuar palët, mediat, shoqërinë civile dhe qytetarët, për punën, shërbimet dhe arrijtë e gjykatës, me qëllim të rritjes së transparencës dhe informimit të drejtë, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

**Detyrat Kryesore:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Udhëheqë zyrën, cakton objektivat si dhe zhvillon planin e punës për përmbushjen e objektivave.....20%
- Përgjigjet për anonimizimin e vendimeve gjyqësore, akteve tjera dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të Gjykatës;.....20%
- Përgjigjet për mirëmbajtjen dhe përditësimin faqes zyrtare të gjykatës, e-mailin zyrtar, përgatit komunikata për media dhe publikun si dhe mirëmban faqen e gjykatës në rrjetet sociale .....10%
- Përgjigjet për protokollin gjatë takimeve të kryetarit, siguron hartimin dhe zbatimin e planit të komunikimit për të informuar qytetarët për punën e gjykatës.....15%
- Përgjigjet për qasjen në dokumente publike sipas legjislacionit në fuqi .....15%
- Siguron aplikimin e standardeve të komunikimit publik, nëpërmjet trajnimeve dhe avancimit, me qëllim që funksionet e zyrës të ushtrohen në mënyrë më efektive dhe efikase.....10%
- Menaxhon stafin e zyrës dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek vartësit dhe bën vlerësimin e rregull të performancës së tyre.....5%
- Kryen detyra tjera sipas kërkesës së kryetarit .....5 %

**Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës:** (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

- Zyrar për Informim dhe Komunikim me Media;

**Niveli i përgjegjësisë financiare:** (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- Nuk ka

**14. Shkathtësitë e kërkuara:** (afësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik.....E nevojshme;
- Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim..... E nevojshme;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit.....E nevojshme;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim.....E nevojshme;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: e preferuar Fakulteti i Gazetarisë ose ndonjë fushë e përafërt.....E nevojshme;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune.....E nevojshme;

**16. Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka:** (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

**Pozita: 3 dhe 4:**

**Titulli i pozitës së punës:** Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa;

**Institucioni:** Gjykata Themelore Pejë: - 1 (një) pozitë; dhe Gjykata Themelore Prizren: - 1 (një) pozitë;

**Kategoria Funktionale:** niveli drejtues

**Grada e Vendet të Punës:/ Koeficienti:** Koeficienti - 9

**Lloji i Vendet të Punës:** pa afat të caktuar, me orar të plotë

**Departamenti/Divizioni/Njësia:** Zyra për Buxhet dhe Financa

**Raporton tek:** i përgjigjet dhe i raporton Administratorit

**Vlerësimi i performancës:** nga Administratorit

**Vendndodhja:** gjykatë përkatëse

**Procedura e aplikimit:** Konkurs i Jashtëm

**Kohëzgjatja e emërimit:** Pa Afat – përfshi periudhën provuese 1 vit

**Arsyeja e rekrutimit:** plotësimi i pozitave të lira sipas organogramit

**Qëllimi i vendit të punës:** (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Përgatitja dhe menaxhimi i buxhetit, pagesa e faturave dhe mbikëqyrja e shpenzimeve të decentralizuara për Gjykatë / degë. Me këtë pozitë synohet të arrihet realizimi i objektivave të Zyrës për Buxhet dhe Financa dhe të Institucionit duke zbatuar legjislacionin në fuqi për çështje buxhetore dhe financiare.

**Detyrat Kryesore:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Udhëheqë, menaxhon dhe mbikëqyrë aktivitetet administrative/financiare të zyrës me qëllim të realizimit të planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor të Gjykatës, në bashkëpunim dhe në koordinim me administratorin e gjykatës;.....25%
- Në bashkëpunim të ngushtë me administratorin, analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme të punës dhe rekomandon për ndryshime/ përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës duke përfshirë edhe propozimet dhe kërkesat buxhetore për Gjykatën/degën;.....20%
- Siguron kontroll të brendshëm në zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve në kohë dhe me kosto efektive si dhe siguron që të gjitha transaksionet të regjistrohen në regjistrin e kontabilitetit të Thesarit (SIMFK-Freebalancit) dhe siguron se të gjitha faturat e rregullta të pranuar të dorëzohen me kohë për pagesë përmes sistemit të Thesarit për shpenzimet nga buxheti i decentralizuar i gjykatës/degës. Sipas nevojës dhe legjislacionit në fuqi, cakton stafin administrativ që ka nën mbikëqyrje, në detyra të caktuara për të siguruar veprimtarinë efektive dhe efikase të punës;.....15%
- Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli për stafin administrativ që ka nën mbikëqyrje si dhe siguron që shpenzimet financiare të jenë në përputhje me planifikimet, rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe përgatit raporte financiare mbi shpenzimet buxhetore të decentralizuara dhe të hyrave në bazë të LMFP-së dhe akteve normative në fuqi;.....10%
- Menaxhon parat e imëta dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është bazuar në parimet e logjistikës sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli si dhe përgatit raporte të rregullta financiare për menaxhimin e gjykatës dhe për Departamentin për Buxhet dhe Financa të Sekretariatit e Këshillit për shpenzimet e decentralizuara të gjykatës/degës;.....10%
- Siguron kontroll të brendshëm, zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve në kohë dhe me kosto efektive;.....10%
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara dhe përgatit raportet javore të punës;.....5%
- Kryen edhe detyra tjetër sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi;.....5%

**Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës:** (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

- Zyrtar Shpenzues;
- Zyrtar për të Hyra / Arkëtar;
- Zyrtar për Buxhet dhe Financa (vetëm në Gjykatën Themelore Prishtinë);

**Niveli i përgjegjësisë financiare:** (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- Sipas legjislacionit në fuqi

**Shkathtësitë e kërkuara:** (afësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe financave.....E nevojshme;
- Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim.....E nevojshme;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit.....E nevojshme;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, komunikuese, menaxhim të performancës.....E nevojshme;
- Fleksibilitet ndaj organizimit, mbikëqyrjes së punës dhe zgjidhjes së problemeve.....E nevojshme;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

**Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës:** (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: drejtimi ekonomik, financa apo biznes....E nevojshme;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune.....E nevojshme;

**Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka:** (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

**Pozita: 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13:**

**Titulli i pozitës së punës:** Referent;

**Institucioni:** Gjykata Apelit: - 1 (një) pozitë; Gjykata Komerciale: - 6 (gjashtë) pozita; Gjykata Themelore Prizren: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Prizren – dega Suharekë: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Pejë: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Gjakovë: - 4 (katër) pozita; Gjykata Themelore Mitrovicë: - 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Gjakovë – dega Malishevë: - 2 (dy) pozita; dhe Gjykata Themelore Ferizaj – dega Kaçanik: - 2 (dy) pozita;

**Kategoria Funktionale:** niveli profesional

**Grada e Vendet të Punës:/ Koeficienti:** koeficienti shtatë (7)

**Lloji i Vendet të Punës:** pa afat të caktuar, me orar të plotë

**Departamenti/Divizioni/Njësia:** Zyra për Menaxhimin e Lëndëve / zyra e Ndihmës administratorit në degë

**Raporton tek:** i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Komerciale/ Mbikëqyrësit të Sektorit në Gjykatë Themelore / Ndihmës administratorit në degë të gjykatës

**Vlerësimi i performancës:** nga Udhëheqësi i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Komerciale/ Mbikëqyrësi i Sektorit në Gjykatë Themelore / Ndihmës administratorit në degë të gjykatës

**Vendndodhja:** Gjykatë/ degë përkatëse

**Procedura e aplikimit:** Konkurs i Jashtëm

**Kohëzgjatja e emërimit:** Pa Afat – përfshi periudhën provuese 1 vit

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas organogramit

Oëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Përgjegjës për pranimin, regjistrimin, menaxhimin, ekzekutimin me lëndët me të cilat është ngarkuar, si dhe administron me rastet e referuara për ndërmjetsim nga gjykata dhe organet administrative, sipas legjislacionit në fuqi, akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detyrat Krvesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Përgjegjës për procesin e pranimin, regjistrimit, menaxhimin dhe ekzekutimit të rregullt të lëndëve në: Sistemin Informativ të Lëndëve (SMIL), funksionimin e rregullt të Sistemit Qendror të Evidencës Penale dhe proceset tjera administrative të menaxhimin të lëndëve në gjykatë;...20%
Pranon dhe regjistron lëndët sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;...20%
Bën ekzekutimin e lëndëve me kohë sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;...20%
Administron me rastet e referuara për ndërmjetsim nga gjykata dhe organet administrative sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli;...10%
Organizon dhe mirë mban shkresat e dosjeve të lëndëve në gjykatë si dhe kujdeset për udhëheqjen e lëndëve të ngarkuara në gjykatë si dhe ofron punë cilësore;...10%
Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon lëndët me të cilat është i ngarkuar si dhe krijon raporte pune për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë duke evidentuar problemet që paraqiten .....10%
Përgatit të gjitha lëndët të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore dhe i raporton te mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli .....5%
Kryen edhe detyra tjetër sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësit dhe përgatitë raportet javore të punës. ....5%

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës: (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

Shkathtësitë e kërkua: (afhtësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit.....E nevojshme;
Shkathtësi në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim.....E nevojshme;
Aftësi të rregullimit dhe ruajtjes së kujdeshme të dosjeve të lëndëve.....E nevojshme;
Aftësi për punë të pavarur dhe vendosje të prioriteteve.....E nevojshme;
Fleksibilitet ndaj organizimit, mbikëqyrjes së punës dhe zgjidhjes së problemeve.....E nevojshme;
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

15. Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik.....E nevojshme;
Së paku dy (2) vite përvojë pune.....E nevojshme;

16. Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka: (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

Pozita: 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për përkthime (Shqip – Serbisht dhe anasjelltas);

Institucioni: Gjkata Komeriale: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë dega Podujevë: - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Gjilan: - 1 (një) pozitë; dhe Gjykata Themelore Gjilan – dega Kamenicë: - 1 (një) pozitë;

Pozita: 21;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për përkthime (Shqip - Anglisht dhe anasjelltas);

Institucioni: Gjykata Komeriale: - 1 (një) pozitë;

Pozita: 22;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për përkthime (Shqip - Serbisht - Anglisht dhe anasjelltas)

Institucioni: Sekretariati i KGJK-së: - 1 (një) pozitë;

Kategoria funksionale: niveli profesional

Grada e Vëndit të Punës:/ Koeficienti: koeficienti shtatë (7)

Lloji i Vëndit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Mbështetje Juridike në GJykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë

Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës në GJykatë / Krey i njësisë ligjore/ ndihmës administratorit në degë

Vlerësimi i performancës: nga Udhëheqësit të Zyrës në GJykatë / Krey i njësisë ligjore/ ndihmës administratorit në degë

Vendndodhja: GJykatë/ degë përkatëse

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese 1 vit

Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas organogramit

Oëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Përkthen materialet simultan dhe me shkrim, duke siguruar një shkallë të lartë të cilësorisë në gjuhët e përdorura gjatë përkthimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detyrat Krvesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Ofron përkthime dhe interpretime gjuhësore për palët në procedurë gjatë seancave gjyqësore, gjatë takimeve të ndryshme, intervistave, konferencave, etj.....20%
Bën përkthimin e të gjitha materialeve (shkresave të lëndës, dekretëve, rregulloreve, ligjeve, komentareve të aplikueshme në Kosovë, korrespondencë gjyqësore zyrtare dhe shkresave tjera sipas nevojës së gjykatës) simultan dhe me shkrim .....20%
Bën përkthim/interpretimin simultan në seanca gjyqësore, takimet zyrtare, konferenca, seminare e të ngjashme;.....10%
Bën përkthimin me shkrim të materialeve dhe dokumenteve si: broshurat, raportet e mediave, komunikatat për shtyp;.....10%
Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim , gramatikës dhe sintaksës;.....10 %
Përkthen të gjitha vendimet gjyqësore, parashtratat tjera të administratës gjyqësore, procesverbalet dhe secilin material që i kërkohet nga personat kompetent;.....10%
Përkujdeset dhe përkthen me shkrim dhe simultan në mbledhje dhe në seanca gjyqësore;.....10 %
Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatitë raportet javore të punës;.....10%

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës: (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

- Nuk ka

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

- Nuk ka

Shkathtësitë e kërkua: (afhtësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit.....E nevojshme;
Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve normative.....E nevojshme;
Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës.....E nevojshme;
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel,).....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë:.....E nevojshme;

- Së paku dy (2) vite përvojë pune.....E nevojshme;

16. Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka: (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

Pozita: 23 dhe 24;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Teknologji Informative;

Institucioni: Gjykata Themelore Prishtinë – dega Graçanicë: - 1 (një) pozitë; dhe Gjykata Themelore Gjakovë – dega Rahovec: - 1 (një) pozitë;

Kategoria funksionale: niveli profesional

Grada e Vëndit të Punës:/ Koeficienti: koeficienti shtatë (7)

Lloji i Vëndit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë

Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Shërbime të Përbashkëta në GJykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë

Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit Zyra për Shërbime të Përbashkëta në GJykatë /

Ndihmëadministratori në degë

Vlerësimi i performancës: nga Udhëheqësi i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta në GJykatë /

Ndihmëadministratori në degë

Vendndodhja: GJykatë /degë përkatëse

Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm

Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat – përfshi periudhën provuese 1 vit

